



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1235 Prot

Lezhë, më 31 / 01 / 2023

VENDIM

Nr. 2, Datë 31 . 01 . 2023

**“PËR PËRDORIMIN E FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN
EKONOMIKE (FONDI 6 %) PËR VITIN 2023”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore” si dhe në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 21, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr . 597, datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” si dhe VKM nr. 868, datë 29.12.2021 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr .597 datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

I.Të miratohen kriteret e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike si më poshtë:

1. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar muajin e fundit nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit me arsyen: Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme.
2. Për të gjitha familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike sipas këtij fondi, duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social - ekonomik në familje nga administratori shoqëror sipas shtojcës 2 të VKM nr.597 datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
3. Gjatë periudhës së trajtimit me fondin deri në 6 % , nëse verifikon që ka ndryshime të situatën social ekonomike, administratori shoqëror, referon familjen për të aplikuar në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Ndhmës Ekonomike apo ndërpret periudhën e përfitimit në rast të punësimit të anëtarëve të familjes.
4. Masa e ndihmës ekonomike për familjet përfituese nga ky fond llogaritet në të njëjtën mënyrë sipas përlllogaritjes së masës së strukturës së familjes, për familjet përfituese të ndihmës ekonomike

(referuar edhe ndryshimeve të parashikuara dhe azhornimeve nga VKM nr. 868 datë 29.12.2021 të lartpërmendur).


II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

III. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI
NDUE LULI**



K.B



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 1235/ prot
01.02.2023

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 93/3 Prot.

Lezhë, më 01 . 02 . 2023

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16, pika 2, gërma "b" të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", në ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", në nenin 29, të ligjit nr.57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", si dhe VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" e ndryshuar, konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 02, datë 31.01.2023, të Këshillit Bashkiak Lezhë "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (fondi 6%) për vitin 2023".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

